

## Udhëtimi i Evlija Çelebiut nëpër Kosovë në vitin 1660

nga  
Robert Elsie

Udhëtari i njohur turk Evlija Çelebi (1611-1684), pseudonimi i Mehmet Zili ibn Dervish-it, ishte biri i një argjenditari në oborrin e sultanit në Stamboll. Nga viti 1640 deri në vitin 1676 ai udhëtoi gjerësisht në Perandorinë Osmane dhe në vendet fqinje në shërbim të Portës së Lartë, d.m.th. të qeverisë osmane. Mbresat i udhëtimeve të tia ruhen në veprën e tij turqisht dhjetëvëllimesh “Sejihatname” (Libri i Udhëtimeve), të cilën ai e mbaroi në Kairo kur ishte i moshuar.

Për Shqipërinë dhe Kosovën e shekullit shtatëmbëdhjetë, Sejihatnameja e Evlija Çelebiut është një burim parësor dhe i pakrahasueshëm të dhënash. Evlijai vizitoi viset shqiptare tri herë. Kreu një udhëtim nëpër Kosovë në dhjetor të vitit 1660, nëpër Shqipërinë veriore dhe Malin e Zi në shkurt 1662, si dhe nëpër Shqipërinë jugore në nëntor 1670.

Për udhëtimin e parë Çelebiu mori shkas nga transferimi i të zotit të tij, Meleq Ahmed Pashës, nga posti i guvernatorit të Bosnjës, me seli në Banja Luka, në atë të guvernatorit të Rumelisë, me seli në Sofie. Bashkë me karvanin e Pashait, Evlijai i ra Kosovës mes për mes, duke bërë ndalesa në Mitrovicë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Kaçanik.

Përkthimet e mëparshme shqip nga Salih Vuçitëri 1930 dhe nga Hasan Kaleshi 1955, kanë qenë të pjesshme dhe në bazë të tekstit të paplotë të shtypur në Stamboll në vitin 1897.

Rrëfimi i plotë i udhëtimit të Evlija Çelebiut në Kosovë paraqitet këtu për herë të parë, dhe në mënyrë shumë më të saktë, në bazë të dorëshkrimit autograf (Libri 5, Bagdat 307, foliot 167a-169a).

### NËPËR KOSOVË, 1660

Prej këndej [Novi Pazar], për ---- orë, mbërritëm në kalanë e lartë të Mitrovicës. Ky emër është latin (sllav) me kuptimin ----. Është ndërtuar nga mbreti Seleshti, njëri nga mbretërit e Serbisë. Ky qytet u pushtua nga vetë Gazi Hudavendigari-i, Sulltan Murat I bir i Gaziut Orhan, në vitin ----. Gjatë betejës së Fushë Kosovës Sulltan Murati shkoi 700.000 të pafë në teh të shpatës. Ndërkohë që ai po kalonte mes për mes fushëbetjës më këmbë, e ndërkohë që trupat e luftëtarëve të tij të rënë po i grumbullonin në breg të lumit Llap, një i pafë ogurzi me emrin Koblaki u ngrit nga pirqjet me kufoma coftinë të ushtarëve të pafë dhe e vrau. Sipas një versioni tjetër, vrasja ndodhi pas betejës, kur ai i pafë, që përmendëm, duke u hequr si lajmëtar, iu afrua sulltanit për t’i puthur dorën, por pastaj nxori kamën dhe e vrau. Dhe më pas i hipi kalit e ia mbathi me të katra. Një numër tepër i madh trupash osmane vrik iu vunë në ndjekje, duke rendur sa andej këndej me armë në dorë, por asnjëri nuk mundi ta qëllojë e ta rrëzojë nga kali. Një grua e moshuar u thirri trupave: “O luftëtarë, i bini kalit në thundër, sepse edhe kali, edhe ai vetë kanë vënë parzmore.” Sapo ajo lëshoi këto fjalë nga goja, një harkëtar krahëfortë qëllloi thundrën e kalit dhe atëbotë të dy, kali dhe kalorësi, u plandosën përdhé. Luftëtarët u grumbulluan përreth, ia shqyen qafolen e parzmore dhe ia shkuan kamën në grykë. Që prej asaj kohe, sa herë që ndonjë lajmëtar i vete afër ndonjërit nga dinastia osmane, sulltani rri ulur në fron dhe lajmëtari puth një mëngë të gjatë qepur rrobës mbretërore, duke u ruajtur mirë në të dyja anët. Në fillim lajmëtari duhet të puthë tokën e më pas mëngën, e cila është tetë pash e gjatë, dhe nuk lejohet t’i afrohet më shumë. Ky ka qenë zakoni sipas ligjit osman qysh nga koha kur Gazi Hudavendigari u vra.

Për shkak të kësaj ngjarjeje, kjo kala e lartë e Mitrovicës quhet Kalaja Ogurzezë. E gjendur në pikën e skajshme perëndimore të rrafshit të Kosovës, mbi të nuk ka ndonjë pikë tjetër më të lartë. Ka trajtë vezake dhe është ngritur me punime guri të latuar. Është jashtëzakonisht e fortë dhe nuk mund të rrezikohet me llagëme ose tunele. Ka vetëm një portë. Brenda nuk ka ndonjë ngrehinë për t'u përmendur.

Rrëzë kalasë rrjedh lumi ----, i cili buron në malet e Pejës në Shqipëri, bashkohet me lumin Llap dhe zbret për t'u bashkuar me Moravën. Në këto vise, kjo kala quhet Mitrovica e Kosovës. Ka edhe një kala që quhet Mitrovica e Sremit, por asaj i kanë mbetur vetëm rrënojat.

Sa një hedhje shigjete larg kalasë është tyrbja e Baba Mustafait, me një teqe, ku banojnë dervishë bektashi, e ku udhëtarët mund të kalojnë natën.

Pranë kësaj teqeje është qyteti i Zveçanit, në skajin më të largët kufitar. Mu te ky vend mbaron ejaleti i Bosnjës. Të gjithë fisnikët e viseve fqinje të Rumelisë u mblodhën në këtë vend në një procesion madhështor për t'i urrear zotni Pashait udhë të mbarë. Ata therën kurbane dhe mishin ua shpërndanë familjeve të varfra. Zotni Pashai fali dy herë namazin në xhaminë e Zveçanit dhe shpërndau sadaká.

Ky qytet i begatë i rrafshit të Kosovës përbëhet prej 300 shtëpish me çati me tjegulla. Ka një xhami, një han, një hamam dhe disa dyqane të hijshëm. Është selia e një guvernatori (hakim) dhe e një vojvode.

Është qytet që përbën njërin skaj të ejaletit të Bosnjës, kurse skaji tjetër është në Malin e Zi. Ky ejalet kufizohet në njërin anë nga Podgorica, Këlmendi dhe kalaja e Kotorrit; në një anë tjetër nga Dubrovniku i Venedikut; në një tjetër nga Burun Kullsi (Kulla e Kepit) dhe \_\_\_\_\_; në një anë tjetër nga qytetet e Pupushkës, Primorjes dhe Splitit; nga perëndimi prej Shibenikut dhe Zadarit; nga veriu prej Zrinit; në njërin anë nga Kanija në sanxhakun e Cernikut; në një anë tjetër nga Pozhegu; në një anë tjetër nga ejaleti i Budës; në një tjetër nga Zvorniku në sanxhakun e Sremit; nga lindja prej Alaxha Hisarit të Rumelisë; dhe në jug nga ky Zveçan dhe nga sanxhaku i Vushtrrisë. Është një ejalet i madh me popullsi të dendur, kurse kalá më të mira se aty nuk gjenden gjetiu.

Dhe tani vjen një përshkrim i qyteteve dhe i fshatrave të ejaletit të Rumelisë.

Pasi dolëm nga Zveçani morëm nga jugu dhe bëmë 7 orë rrugë mes për mes rrafshit të pafund të Kosovës derisa mbërritëm në sanxhakun e lashtë (liva), qyteti i rrethuar me mure i Vushtrrisë. Ky emër është latin me kuptimin ----. Është themeluar nga mbretërit e Serbisë. Më 792 (1389) u pushtua nga vetë Gazi Hudavendigari. Pas pushtimit, kalaja u rrafshua me themel për të mos u bërë kurrë në të ardhmen strehë për të pafetë. Ende i duken themelet. Është seli e një sanxhak-beu të ejaletit të Rumelisë si dhe dhuratë perandorake beut kundrejt të ardhurave prej ---- akçesh. Ky sanxhak përfshin ---- zeamete dhe ---- timare. Ai ka një allajbej, një çeribash dhe një kapiten (jyzbash). Me ligj, ai duhet të mbledhë 4.000 burra të armatosur bashkë me shoqëruesit e armatosur të këtyre timariotëve dhe ushtarët e beut. Ai ka një myfti, një nakibyleshraf dhe një kadi me një nivel page prej 150 akçesh. Ka përqark ---- fshatra. Ka gjithashtu një qehaja të spahinjve, një komandant të jeniçerëve, një inspektor finance, një tagrambledhës, një nëpunës të taksës për frymë, si dhe fisnikët e parinë e vet.

Ka gjithsej ---- mëhalla, prej të cilave më me emër janë mëhalla e Dëshmorëve, mëhalla Allajbej-zade, mëhalla e Vjetër, mëhalla e Sipërme dhe mëhalla e Poshtme. Ka 2000 shtëpi një- e dykatshe në gjendje të mirë, me mure guri e çati me tjegulla.

Gjithsej ka ---- faltore. E para fare, në pazar, është Eski Xhamia (Xhamia e Vjetër), e cila mbahet nga vakëfe bamirësie të themeluara prej Hudavendigarit (Sulltan Murad I). ---- Të gjitha të tjerat janë xhami lagjesh (mesxhide). Ka një medrese, teqe, shkolla, si dhe një numër hanesh. Afër godinës së gjykatës gjendet një hamam me pak dritë. Pazari është i vogël, pa bezistan e pa vende për të ngrënë, por të gjitha shtëpitë e qytetit ua hapin dyert me mikpritje të madhe udhëtarëve. Para se të fillonte fushata ushtarake për pushtimin e Kretës, sarajet e 150 fisnikëve e të parisë u mbyllën e mbetën shkret dhe, për këtë arsye, qyteti erdhi

duke u rrënuar. Bëftë emër zoti që t'i kthehet begatia, sepse ai gjendet në rrafshin e pamatë e pjellor të Kosovës dhe është i bekuar nga një klimë e këndshme. Është qytet i veçuar, në tokat e të cilit, rrëzë maleve të Novobërdës, ka shumë vreshta e kopshtije.

Nëpër këtë pjesë të rrafshit kalon lumi Llap, i cili buron në Shqipëri, bashkohet me lumin ---- rrëzë kalasë së sipërpërmendur të Mitrovicës, e më pas bashkohet me Moravën, i cili derdhet në Danub.

Banorët e Vushtrrisë janë rumeliotë. Pjesa më e madhe nuk flasin boshnjakçe, por flasin shqip e turqisht. Ata vishen me petka cohe e qyrk dhe në kokë mbajnë kallpak të kuq me kurorë të ulët gëzofi a shqarthe. E kanë zakon ta përveshin (?) gëzofin e kallpakut, çka bën që t'u duket rrethi e theka e zezë prej mëndafshi në anët. Kanë breza "teybend," mbajnë kama të tipit "kortela varsak," dhe veshin tirqe të kuq me kopsa të argjenda, si dhe këpucë të hijshme "kubadi." Këto janë veshjet e bukura të rumeliotëve.

Dolëm nga ky qytet dhe morëm udhën anës brigjeve të lumit Llap mes për mes rrafshit të Kosovës në drejtim të jugut. Ja tyrbja e Sulltan shehidit, Gazi Hudavendigar, i qoftë i lehtë dheu përsipër, dhe zoti e bekoftë shenjtërinë e tij. I ramë asaj hapësire në brigjet e lumit Llap, të mbetur siç e ka bërë perëndia, dhe shkuam te vendi ku zemra fisnike e organet e tjera të brendshme të Sulltanit tonë të martirizuar Murad I prehen në atë tyrbe me kube të lartë. Sikundër e përmenda më parë, në vitin 792 (1389) këtu është zhvilluar një betejë e madhe, në të cilën Koblaki i mallkuar e ogurzi vrau një sulltan aq të shkëlqyer. Sulltanit i hapën barkun, i nxorën veshkat, mëlçinë e zemrën dhe ia varrosën këtu. Më pas kjo tyrbe madhështore u ngrit nga Sulltan Bajazidi I Vetëtima.

Në viset e Perandorisë Osmane janë zhvilluar ---- beteja të mëdha. E para ka qenë kjo e Fushë Kosovës. Një tjetër ka qenë beteja e Sulltan Bajazidit I Vetëtimës. Kurse një tjetër betejë ka qenë ajo e Muradit II, atit të Mehmed Pushtuesit, kundër vllahëve dhe moldavëve në luginën Ugrash afër Varnës. Një betejë tjetër e madhe ishte ajo që u zhvillua në luginën e Terxhanit afër Erzurumit ndërmjet Mehmed Pushtuesit dhe Sulltan Uzun Hasanit, mbretit të Azerbaixhanit, në vitin ---- të datuar sipas kronogramit "Batlan keydü' l-hayinin" ("Të kota janë planet e tradhtarëve"). Ia vlen të përmendet një betejë tjetër, ajo e Çaldiranit në vitin ---- ndërmjet Shah Ismailit dhe Selim Shahinit. Një tjetër ka qenë beteja e Mohaçit në vitin ---- kur Sulejman Hani vrau mbretin Lajosh bashkë me 700.000 të pafë. Një tjetër ka qenë beteja në pllajën e Mezëkerestesh (Mezökeresztës) afër Erlaut në vitin ---- kur shtatë mbretër u shuan fare bashkë me 700.000 të pafë. Zotit të bekuar i qofshim falë që, në të shtatë gazatë e sipërpërmendura, mbretërit e pafë u vranë të gjithë. Mirëpo, pas betejës së Fushë Kosovës, Gazi Murat Hani u vra me dredhi në një çast pushimi, dhe zemra e tij fisnike u vu të prehej në këtë tyrbe të ndritshme. Sa për trupin e tij të bekuar, ai sot prehet i varrosur në tyrben madhështore të ngritur në oborrin e Xhamisë së Madhe në vendin e quajtur Eski Kaplica (Llixhat e Vjetra) në Bursë e që është bërë vend përnderimi.

Një gjë e çuditshme na ndodhi kur po hynim në këtë tyrbe të Fushë Kosovës. Edhe fundi i xhybes së tynzotit Meleq Ahmed Pasha qe laparosur nga të pëgërat. Me sa duket, të gjithë rajatë e pafë të fshatrave përqark e kishin bërë zakon të ndaleshin para tyrbes kur shkonin në Prishtinë e në Vushtri dhe, për fyerje, e kryenin nevojën aty. Meleq Ahmed Pashës i hipi gjaku në kokë kur pa atë pisllek dhe ndjeu atë duhmë të pështirë.

"O Perëndi," thashë, "ai i pafë ogurzi, që preu këtë sulltan, prehet në një manastir matanë atij mali në një varr të bukur, të ndriçuar me llamba të stolisura nga mjeshtër e të ujditura me erë të mirë myshku e amberi gri. Ai mbahet mirë me bamirësi e blatime të pasurish nën kujdesin e murgjve, të cilët ditë e natë presin e përcjellin mysafirë, qofshin të pafë ose myslimanë. Tyrbja e sulltanit tonë ngadhnjimtari, nga ana tjetër, nuk ka ndonjë vakëf apo person që ta mirëmbajë, dhe ç'ndodh, të gjithë të pafetë vijnë këtu dhe pabesisht ndyejnë duke bërë nevojën. Duhet të thirrni të pafetë e fshatrave përreth dhe t'i detyroni ta pastrojnë e ta rregullojnë tyrben. Me një barrë akçe, të nxjerra nga hasi i Zveçanit, mund të ngriheshin mure të lartë rreth tyrbes dhe mund të caktohej një kujdestar për të banuar këtu bashkë me

familjen.”

Pas kësaj, Pashai i dha popullatës së vilajetit dy qese me kurush dhe e thirri rajanë e zonës përreth për ta pastruar tyrben. Brenda një jave ata ngritën qark tyrbes një mur të lartë me një portë madhështore, në mënyrë që të mos hyhej hipur mbi kalë. Gjithashtu, mbollën 500 drurë frutorë dhe hapën një pus. U caktua një kujdestar, që të banonte aty bashkë me familjen, me një pagë të rregullt nga vojvoda i Zveçanit. Detyra e tij ishte të merrej me mirëmbajtjen e qilimave prej mëndafshi, shandanëve, tymtoreve, enëve me ujë trandafili dhe llambave të tyrbes dritëplotë. Njëkohësisht, fisnikët e vilajetit caktuan një nëpunës për të mbikqyrur këtë institucion bamirësie. Kështu u krye një akt dashurie, dhe sot ai është bërë vend përnderimi - mëshira e Zotit rëntë mbi të!

Rrethqark kësaj tyrbeje dritëplotë prehen varret e mëse 10.000 dëshmorëve dhe njerëzve të shenjtë, ndër të cilët janë Baba Alemdari, shehu Shehid Iljas Dede, Jasavul Beu bir i Temyrtash Pashës, si dhe mijra dëshmorë të tjerë. ----

Me të përfunduar vizitën këtu, morëm udhën dalngadalë drejt lindjes dhe mbërritëm në kalanë e ----, dmth. në Prishtinë. Emri është latin me kuptimin ----. Është themeluar nga mbretërit serbë dhe u pushtua në vitin 792 (1389) nga Sulltan Murad I, i cili e rrafshoi kalanë me themel. Administrohet nga një vojvodë brenda ejaletit të Rumelisë. Ka një kadi me një nivel page 150 akçe, i cili nxjerr edhe një të ardhur të ligjshme prej pesë qesesh në vit nga --- - fshatra. Ka një qehaja [i spahive], një komandant të jeniçerëve, dhe shumë fisnikë e njerëz të parisë. Qyteti gjendet në verilindje të rrafshit të Kosovës. Ka ---- mëhalla dhe 2060 shtëpi një- e dykatëshe me muratura e me çati me tjegulla. Të gjitha kanë oborre të mëdha me vreshta e kopshtije. Ndër ata janë saraja e Koxha Bodur Allajbeut dhe godina e gjykatës. ----

Gjithsej ka 12 faltore, gjashtë prej të cilave janë xhami për t’u falur. E para sosh, në pazar, është ----. Të tjerat janë xhami lagjesh. Ka ---- medrese, ---- shkolla hadithi, ----shkolla filllore, dhe ---- teqe dervishësh. Ka ---- çesma.

Numri i haneve është 11. Në Hanin e Haxhi Beut gjendet ky kronogram:

“Jemi krenar që datën ta themi me fjalë:  
Ky han u ndërtua më 1032 (1623).”

Në pazar ka hane të tjerë, por asnjë godinë publike me çati plumbi.

Gjithsej ka ---- hamame. Në pazar gjendet hamami i Sulltan Mehmed Pushtuesit. Ai është kthyer në vend përnderimi, sepse një njeri i shenjtë një herë u mbyll për dyzet ditë në një nga kthinat në të djathtë të këtij hamami dhe shqiptoi këtë lutje: “O Zoti im, gjettë shërim çdo i sëmurë që hyn këtu.” Edhe sot e kësaj dite, të gjithë ata që kanë ndonjë sëmundje dhe vijnë këtu, gjejnë shërim, me urdhër të Zotit. Po në pazar është edhe Hamami i Vjetër, mënyra e ndërtimit dhe atmosfera e të cilit vetvetiu të çelin shpirtin e të japin energji e gjallëri. ----

Ndonëse nuk ka bezistan me mure, ka 300 dyqane, të cilat sot janë pak për përmasat e këtij qyteti. Megjithatë, në to gjen ç’ të duash.

Falë klimës së mirë, djemtë dhe vashat këtu janë me emër në të gjitha trevat osmane për bukuri. Ka vreshta e kopshtije pa hesap, me dardha e rrush mjaft të pëlqyer. ---- Paria dhe familjet në gjendje të mirë e kanë për kënaqësi të presin mysafirë të pasur e të varfër qofshin, të rinj e të moshuar të cilët gjejnë këtu mikpritjen më të pakursyer. Asnjë natë nuk kalon pa mysafirë. ----

Prej këndeje u nisëm dhe mbërritëm në fshatin Dobratin, i cili është latin me kuptimin - ----. Ai është zeamet i lirë dhe është fshat i bukur, i begatë e pjellor me 500 shtëpi.

Prej këndeje morëm udhën drejt lindjes dhe mbërritëm në kalanë e ----, dmth. në Kaçanik. Prejardhja e këtij emri ka të bëjë me ndodhinë e disa kusarëve shqiptarë, që dikur kishin bërë një grabitje në Shkup dhe më pas kishin marrë arratinë deri këtu, me shpresë se do të gjenin një vend për të pushuar, por i kapën e i masakruan. Prandaj ky vend mori emrin

Kaçanlar (“Të arratisurit”), që më pas erdhi e mori trajtën Kaçanik. Më vonë, në vitin ----, Sinan Pasha, pushtuesi i Jemenit, ngriti një kala të bukur me mure në hyrjen e grykës dhe në brigjet e lumit Lepencë. Ajo ka trajtë katrore me perimetër 800 hapa. Një e metë është se gjendet në luginë dhe qarkohet nga shumë pika më të larta. Kështjella ka një dizdar, një garnizon prej 50 ushtarësh, dy topa dhe një portë. Brenda janë 40 a 50 shtëpi që shërbejnë për strehimin e ushtarëve, por ndërtesa publike nuk ka. Jashtë mureve janë 100 shtëpi të tjera, të gjitha me çati me tjegulla e me kopshte.

Në qytet është një xhami e hijshme, pragu i së cilës ka sipër këtë kronogram:

“Falë Zotit, një dashamir ka shqiptuar datën e saj:

Një tempull i bukur dhe vend lavdiplotë. 1003 (1594).”

Ka një teqe bektashie, një shkollë fillore, një han të madh rrëzë një shkëmbi, si dhe një hamam të vogël. Nuk ka kurrfarë gjurmë pazari, sepse Shkupi është afër. Lumi ---- kalon përmes Kaçanikut, vijon nëpër këto lugina dhe shkon me anë të ujësjellësit të Gazi Isa Beut në Shkup, ku u shpërndahet haneve, hamameve dhe medreseve - një vepër publike e shkëlqyer! Në Kaçanik ka selinë një kadi me nivel page 150 akçe dhe kjo detyrë u është dhënë dhuratë për jetë pasardhësve të Vejsi Efendiut nga Shkupi. Administrohet nga një vojvodë dhe bën pjesë në sanxhakun e Shkupit.

Prej këndej morëm rrugën e Shkupit dhe, pasi bëmë një vizitë në mekamin e Dyzet Shenjtorëve, mbërritëm në Shkup pas ---- orësh.